



RAPORT MBI AKTIVITETIN E KI 2022

Maj 2023



Këshilli i Investimeve (KI) ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. KI kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që nxisin mirëfunksionimin e tregut.

KI kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues të qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve për zhvillim.

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).

Përmbajtja

06 Hyrje	16 Konsultime	21 Komunikim dhe Vizibilitet	27 Planet për të ardhmen
08 Aktivitetet Kryesore gjatë 2022	18 Rekomandime të përmbushura gjatë vitit 2022	22 Angazhimi i partnerëve	28 Numra të Rëndësishëm 2022
10 Klima e Investimeve	20 Forcimi i zbatimit të reformave	24 Të tjera	29 Anëtarë të KI gjatë 2022
12 Mbledhje Plenare	20 Dokumente	26 Anketat e KI mbi aftësitë dhe disponueshmërinë e fuqisë punëtore, dhe sfidat e fuqisë së re punëtore (2022)	



“Këshilli i Investimeve ka luajtur një rol të rëndësishëm në adresimin e aspekteve thelbësore të zhvillimit ekonomik të vendit ndër vite, duke përfshirë formalizimin e ekonomisë, nxitjen e rritjes së sektorëve kyç si turizmi dhe bujqësia dhe kryerjen e anketave për administratën tatimore për të përmirësuar procedurat dhe shërbimet tatimore ofruar për bizneset. Është thelbësore që ne të vazhdojmë të angazhohemi në dialog konstruktiv për të përmirësuar më tej klimën e investimeve në Shqipëri dhe për të promovuar një rritje të qëndrueshme ekonomike.”

Ministre e Financave dhe Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj
Kryetare e Këshillit të Investimeve
Tiranë, 31 janar 2022

OBJEKTIVAT E VEPRIMTARISË GJATË 2022

Në përputhje me objektivin kryesor të Këshillit të Investimeve (KI) për forcimin e besimit midis aktorëve kryesorë dhe institucionalizimin e dialogut politik mbi klimën e investimeve në vend, puna e Sekretariatit u bazua në shtyllat e mëposhtme:

PËRCAKTIMI I AXHENDËS SË KI NË LINJË ME PRIORITETET E BIZNESIT DHE REFORMAVE TË QEVERISË

Fokusimi në fushat prioritare të ndërhyrjes për vitin 2022, si rritja e proceseve të konsultimit publik dhe trajtimi i problematikave të lidhura me fuqinë punëtore.

OFRIMI I TË DHËNAVE TË PËRDITËSUARA MBI PERCEPTIMET E BIZNESIT

Kryerja e anketave për të marrë perceptime të përgjithshme të biznesit lidhur me përmirësimin e

konsultimit publik dhe sfidat e tregut të punës, si dhe një pyetësor me të rinjtë për të kuptuar pengesat e tyre specifike në lidhje me aksesin në tregun e punës.

FORCIMI I BASHKËPUNIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KI

Rritje e bashkëpunimit me institucionet publike, veçanërisht me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadrin e përditësimit të informacionit mbi ecurinë e rekomandimeve të KI.

PËRFSHIRJA E KI NË PROCESET E POLITIKËBËRJES

Lehtësimi i përfshirjes së Këshillit të Investimeve në politikëbërje përmes vendosjes dhe forcimit të bashkëpunimeve me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

RRITJA E TRANSPARENÇËS DHE LLOGARIDHËNIES SË KI

Publikimi i rregullt i procesverbaleve dhe axhendave të mbledhjeve të KI, kryerja e vlerësimeve të brendshme mbi efektivitetin dhe ndikimin e KI, si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit të sektorit privat nëpërmjet anketave dhe konsultimeve.

HYRJJE

Gjatë vitit 2022, Këshilli i Investimeve (KI) ka mundësuar diskutimin sistematik të bazuara në evidencë përmes organizimit të tre mbledhjeve plenare dhe pesë tryezave teknike, me pjesëmarrjen e 173 bizneseve dhe miratimin e 21 rekomandimeve të reja. Qasja e KI ndaj gjithëpërfshirjes, ndërgjegjësimit dhe angazhimit aktiv të të gjitha palëve të interesuara ka rritur interesin e shoqatave të biznesit për t'u bërë anëtare të KI-së.

Përveç mbledhjeve plenare dhe tryezave të rrumbullakëta, Sekretariati i KI-së ka përgatitur tetë analiza teknike, përfshirë dy nota teknike dhe katër anketa me kontributin e sektorit privat, partnerëve dhe të rinjve.

Këto analiza kanë trajtuar problematika që lidhen me tema të ndryshme, si konsultimi publik, fuqia punëtore dhe sfidat që përballet biznesi për të investuar në energjinë e rinovueshme. Përmes tyre, janë ofruar njohuri dhe të dhëna të vlefshme, që kanë shërbyer si bazë diskutimi në mbledhjet plenare dhe në hartimin e rekomandimeve përkatëse të KI-së.

Përfshirja e KI në politikëbërje u konsolidua dhe u harmonizua më tej me qasjen e re strategjike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) për priorizimin e problematikave dhe sugjerimeve të biznesit. Sekretariatit iu deleguan përgjegjësi të veçanta për të mbështetur procesin e konsultimit të MFE-së, duke rezultuar në përfshirjen e 26 rekoman-

dimeve të KI-së në planin e Ministrisë si ndërrhyrje të rëndësishme. Disa nga rekomandimet e sektorit privat të KI-së nga viti 2015 deri në vitin 2022 janë përdorur si inpute në procesin përgatitor të Strategjisë Kombëtare të Punësimit 2022-2030 dhe draftin e Strategjisë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, duke treguar kështu kontributin dhe ndikimin e KI-së në politikëbërje.


Gjithashtu, Sekretariati i KI ka kontribuar në forume dhe konferenca të ndryshme, duke përfshirë “Konferencën e Parë të Nivelit të Lartë kundër Korrupsionit”. KI gjithashtu ka zgjeruar partneritetet e tij duke bërë më shumë përpjekje për të punuar me akademinë dhe shoqatat e të rinjve për të gjetur zgjidhje efektive për forcimin e sektorit privat dhe përmirësimin e klimës së investimeve. Gjithashtu, Grupi i Punës i Këshillave të Investimeve të krijuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me pjesëmarrjen e 11 Këshillave të Investimeve nga vende të ndryshme, vlerësoi Sekretariatit Shqiptar për praktikatat e mira të komunikimit me partnerët e tij dhe e paraqiti atë si model për Këshillat e tjerë.

Referuar vlerësimit të partnerëve mbi punën e KI-së gjatë vitit 2022, progresi i dedikohet më shumë promovimit të një modeli politikëbërje bazuar në evidencë, nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe angazhimit aktiv të të gjithë aktorëve, si dhe kontributin në përmirësimin e mjedisit të biznesit në vend dhe luftën kundër korrupsionit. KI konsiderohet si një platformë e vlefshme dhe e besueshme për sektorin privat dhe një partner i rëndësishëm në përpjekjet e qeverisë për të nxitur rritjen dhe zhvillimin ekonomik.



AKTIVITETET

Kryesore gjatë 2022



KLIMA E INVESTIMEVE

Në përgjithësi, pavarësisht pasojave të tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë së COVID-19 në ekonominë e vendit, të dhënat statistikore vërtetojnë se situata e përgjithshme ekonomike në fund të vitit 2020 ishte dukshëm më pak e rëndë se sa pritej në fillim të pandemisë dhe përgjatë vitit 2021, ritmi i rimëkëmbjes së ekonomisë ishte dukshëm më i shpejtë se pritshmëritë fillestare. Pavarësisht ndikimit negativ të luftës në Ukrainë, stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë. Ndryshimet kryesore në kontekstin jepen shkurtimisht më poshtë:

POLITIKË:

Në korrik 2022, Bashkimi Evropian (BE) dhe Shqipëria zhvilluan në Tiranë Konferencën e parë Ndërqeveritare e cila shënoi zyrtarisht hapjen e procesit të negociatave për anëtarësimin e vendit në BE. Pas këtij hapi madhor, Shqipëria pritet të përmbushë kërkesat e tregut të brendshëm të BE-së, të transpozojë acquis të shumtë në legjislacionin kombëtar dhe të hartojë dhe zbatojë strategji dhe plane të shumta veprimi. Në këtë këndvështrim, komuniteti i biznesit pritet të luajë një rol aktiv në konsultimin dhe miratimin e legjislacionit sektorial të pjesëve të caktuara të kapitujve të rëndësishëm që nxisin tregun e lirë dhe lëvizjen e lirë të kapitalit dhe njerëzve. Në fund të vitit 2022, takimet teknike Shqipëri-BE për shqyrtimin analitik të kapitujve të grupit të parë "Bazat" filluan në Bruksel dhe pasuan gjithashtu në fillim të vitit 2023, ku Sekretariati i KI-së u promovua si një platformë e suksesshme konsultimi kombëtar që lehtëson dialogun publik-privat dhe përfshirjen e biznesit në një proces të tillë. Gjithashtu, më 6 dhjetor 2022, në Tiranë u mbajt "Samiti BE-Ballkani Perëndimor", i cili

u organizua për herë të parë në historinë e BE-së në një vend joanëtar. Deklarata e Tiranës rikonfirmoi mbështetjen e qartë të BE-së mbi perspektivën e BE-së për Ballkanin Perëndimor.

DINAMIKA KRYESORE LIGJORE DHE RREGULLATORE:

Në kontekstin e krizës globale dhe ndërprerjes së zinxhirëve të furnizimit për shkak të luftës në Ukrainë, çmimeve të paprecedentë të energjisë dhe rritjes së inflacionit, Qeveria Shqiptare miratoi akte normative në mars 2022 dhe themeloi Bordet e Transparencës. Arsyetimi dhe synimi i Qeverisë Shqiptare pas këtyre masave ishte administrimi i furnizimit me naftë dhe gaz dhe monitorimi i çmimeve të produkteve ushqimore bazë, si dhe mbrojtja e tregut të brendshëm nga deformimet dhe zhvillimet në tregun ndërkombëtar. Të dyja aktet

normative u ankuan në Gjykatën Kushtetuese, me arsyetimin kryesor çënimin e konkurrencës së lirë. Krahas sa më sipër, projektligji "Për tatimin mbi të ardhurat" u hodh për konsultim publik dhe u bë objekt i një debati të madh mes profesionistëve dhe grupeve të interesit. Në mes të një debati të tillë, diskutimi dhe miratimi i tij në Kuvendin e Shqipërisë u shty për në vitin 2023, ndërsa Kuvendi miratoi paketën fiskale, e cila ndër të tjera rriti akcizën për prodhuesit vendas të birrës.

Investitorët-prodhues në sektorin e energjisë u ndikuan nga miratimi i ligjit 98/2022 "Për krijimin e kontributit të solidaritetit gjatë kohëzgjatjes së krizës energjetike" mbi bazën e të cilit u vendos një taksë e jashtëzakonshme, objekt përlogaritjeje dhe zbatimi në 2023. Krahas sa më sipër, Qeveria hodhi për konsultim publik nismën dhe më pas projektligjin

Në vitin 2022, sipas të dhënave paraprake, **ekonomia pati një rritje prej 4.84%** krahasuar me një vit më parë.



"Për Amnistinë Fiskale dhe Penale", i cili u bë objekt diskutimesh dhe opinionesh lidhur me zbatimin dhe qëllimin e tij.

Në fund, si hapi përfundimtar i miratimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Investimeve për investimin strategjik të Portit të Durrësit, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin 79/2022. Investimi i promovuar kryesisht nga Qeveria Shqiptare si porti më i madh turistik në Mesdhe, vlerësohet të jetë më shumë se 2 miliardë euro në 2 faza zhvillimi dhe 100% e investimit të saj do të mbulohet nga investitori i huaj. Aksionet e shtetit shqiptar dhe pjesëmarrja në sipërmarrje të përbashkët do të mbeten të pandryshuara në masën 33% të kapitalit të shoqërisë. Investitori përjashtohet nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, kontributin social të banesave dhe masat mbështetëse përmendur më lart, ndërsa Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për dhënien e të gjitha licencave dhe lejeve brenda 150 ditëve. Gjithashtu, toka e ndërtimit do të transferohet investitorit, me përjashtim të zonave detare dhe portale strategjike.

EKONOMIKE:

Pas recesionit të fortë të vitit 2020, në normën -3.5%, ekonomia u rikuperua fuqishëm në vitin 2021, në masën 8.5%. Në vitin 2022, ekonomia e vendit vazhdoi të performojë sërish me rritje pozitive dhe relativisht të lartë, pavarësisht ndikimit negativ në ofertë. Në vitin 2022, sipas të dhënave paraprake, ekonomia pati një rritje prej 4.84% krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, inflacioni e kaloi objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3%, me një normë mesatare vjetore prej 6.7%. Norma më e lartë e inflacionit prej 8.3% u regjistrua në tetor 2022. Flukset e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) gjatë vitit 2022 shënuan një rritje të ndjeshme prej 32.6% krahasuar me vitin 2021, si dhe stoku i IHD-ve gjithashtu u rrit me 18.8%. Gjatë vitit 2022, fitimi i riinvestuar përbënte 53% të totalit të fluksit të IHD-ve. Holanda mbeti burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve me 219 milionë euro dhe investimet në pasuri të paluajtshme ishin sektori më tërheqës për IHD-të në vitin 2022. Shkalla zyrtare e papunësisë në vitin 2022 u regjistrua në 11%, duke shënuar një rënie prej 0.5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

MBLEDHJE PLENARE



Si mundet të përmirësohet prioritizimi/harmonizimi i ndërhyrjeve strategjike të qeverisë për vitin 2022 në fushën e përmirësimit të klimës së biznesit duke përfshirë edhe rekomandimet e biznesit?

Cilat janë perspektivat e biznesit dhe si mund të përmirësojë qeveria bashkëpunimin për të stimuluar investimet, për të inkurajuar bizneset dhe për të përmirësuar kushtet ekonomike në vend?

MFE pranoi paraprakisht 194 rekomandime nga organizata të ndryshme të biznesit lidhur me fusha si legjislacioni tatimor, rregullat bankare dhe investimet e huaja. Pas shqyrtimit të tyre, MFE formuloi një plan për të adresuar shqetësimet e biznesit duke synuar edhe reduktimin e ndryshimeve të shpeshta në legjislacion. Më 31 janar 2022, KI zhvilloi një mbledhje të posaçme për të diskutuar shtyllat e ndërhyrjes së qeverisë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend dhe për të përcaktuar axhendën e KI për vitin 2022. Ministrija e Financave dhe Ekonomisë theksoi rëndësinë e konsultimeve paraprake me komunitetin e biznesit, dhe prezantoi një kalendar pune ku ftoi komunitetin e biznesit dhe palët e interesuara për të qenë pjesë e grupit teknik të punës që në fazat fillestare të ndërhyrjeve. MFE synonte prioritizimin për zbatimin e këtyre rekomandimeve deri në fund të qershorit 2022.

SUGJERIMET KRYESORE TË BIZNESIT

- Zgjidhja e problemeve teknike në lidhje me fiskalizimin dhe reduktimi i kostove dhe gjobave joproporcionale brenda gjashtë muajve të ardhshëm.
- Prioritizimi i zbatimit të ligjit për konsultimin publik.
- Krijimi i një kuadri ligjor që mbron bizneset nga ndikimi i kushteve ekonomike globale.
- Promovimi i dixhitalizimit në vend për të lehtësuar zbatimin e suksesshëm të fiskalizimit.
- Luftimi i mëtejshëm i informalitetit duke kufizuar dhe dekurajuar pagesat me para në dorë.



“Për prodhuesit shqiptarë, hapja e shumëpritur e negociatave sjell pasiguri për të ardhmen e të bërit biznes. Prandaj, është thelbësore për ne që të kemi një dialog publik nëpërmjet platformave të diskutimi, informimit dhe sensibilizimit mbi atë se çdo të thotë treg i përbashkët evropian për një prodhues shqiptar. Vetëm atëherë mund të kuptojmë plotësisht sfidat dhe mundësitë që na presin dhe të marrim vendime të informuara për të ardhmen e bizneseve tona.”



Arben Shkodra,
Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, 31 janar 2022



Si mund të zgjidhen sfidat dhe kufizimet e konsultimit publik që procesi të jetë efektiv dhe kuptimplotë?

Si konsiderohen komentet e palëve të interesuara gjatë konsultimeve publike?

Procesi i konsultimit publik në Shqipëri ka nevojë për përmirësim të cilësisë së tij dhe të fokusohet edhe në përmbajtje, jo vetëm në aspektin procedural. Komuniteti i biznesit ka shprehur shqetësimin se ligjet dhe aktet nwnligjore përfundimtare nuk reflektojnë komentet e tyre dhe ka raste që edhe afatet për paraqitjen e komenteve nuk respektohen. Ligji për informimin dhe konsultimin publik nuk përmban procedura detyruese për të siguruar zbatimin efektiv të tij. Megjithatë ka pasur rezultate pozitive, procesi i konsultimit është kryesisht formal dhe nuk reflekton në mënyrë të vërtetë një proces të rregullt.

» **A është** ende një sfidë për sektorin privat përdorimi i regjistrat elektronik në kuadër të reformës së dixhitalizimit, si instrumenti kryesor i përcaktuar me ligj për njoftimin dhe konsultimin publik?

» **Si mundet** sektori privat të përmirësojë kapacitetet e tij për të përfituar sa më shumë nga procesi i konsultimit dhe për të menaxhuar shpenzimet përkatëse në mënyrë më efikase?

REKOMANDIME KRYESORE

- **Përmirësimi i funksioneve të regjistrat elektronik** për njoftimin dhe konsultimin publik për të siguruar akses të lehtë për të gjitha palët e interesuara.
- **Raportet e Vlerësimit të Ndikimit (RIA/VNR)**, si dokumenta thelbësorë konsultimi në vetvete, të jenë objekte të konsultimit publik që në fazat e hershme të konceptimit të projektaktit, duke sugjeruar alternativa ndaj zgjidhjeve rregullatore.
- **Të zgjerohet objekti i ligjit nr. 146/2014** “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” duke shtuar draft aktet nënligjore normative.
- **Rritja e kapaciteteve të shoqatave/dhomave të tregtisë** dhe puna drejt një standardi më të lartë ndërveprimi në proceset e konsultimit të politikave publike të vendit.

“Konsultimi publik është thelbësor dhe një nga shtyllat e punës së Amcham. Në këtë drejtim ka një përfshirje të ulët të sektorit privat dhe arsyeja kryesore ka të bëjë me mungesën e besimit. Ndërsa ekziston një platformë për konsultim publik, ajo ka të meta të konsiderueshme. Analiza e Dhomës Amerikane tregon se mbi 50% e ligjeve të miratuara nuk i nënshtrohen rregullave të përcaktuara me Ligjin për Konsultimin Publik, i cili është një ligj i mirë. Ne besojmë se një mekanizëm zbatues është i nevojshëm për të përmirësuar efektivitetin e ligjit dhe për të siguruar zbatimin e tij.”

Enio Jaço, Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AmCham), 1 qershor 2022

Si ndikon niveli i aftësive të fuqisë punëtore në konkurrueshmërinë e bizneseve vendase?

» **Si mund** të optimizohen përpjekjet vendase dhe ndërkombëtare për të adresuar çështjet e sektorit privat që lidhen me disponueshmërinë dhe cilësinë e aftësive punëtore?

REKOMANDIME KRYESORE

Fuqia punëtore po zvogëlohet, ndoshta kryesisht për shkak të emigrimit dhe migrimit brenda vendit. Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT (janar 2022), popullsia në Shqipëri u ul me 1.3% krahasuar me një vit më parë. Struktura ekonomike e vendit dominohet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), të fokusuara kryesisht në sektorin e tregtisë. Mungesa e njohurive sipërmarrëse dhe teknologjike, së bashku me informalitetin e lartë, investimet e pamjaftueshme në kapitalin njerëzor dhe fizik dhe shpenzimet e ulëta për kërkim dhe zhvillim, pengojnë konkurrueshmërinë e vendit.

» **Si mundet** Shqipëria të ruajë strategjikisht fuqinë e saj punëtore, veçanërisht të rinjtë, gjatë një “krize globale të fuqisë punëtore”?

- Sipërmarrësit duhet të investojnë në qëndrueshmërinë e stafit, duke përfshirë përmirësimin e paketave të shpërblimit, shëndetin dhe mirëqenien për punonjësit, rikualifikimin (përfshirë aftësitë e buta), strukturimin e mundësive për karrierë dhe rivlerësimin e praktikave të studentëve.
- MFE të marrë në konsideratë instrumente novatore për ndërgjegjësimin e NMVM-ve për mekanizmat ekzistues që mbështesin punësimin përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm në nivel lokal ndërmjet dhomave të tregtisë së biznesit, zyrave të punësimit, shkollave profesionale, qendrave të formimit profesional, qeverisjes vendore dhe universiteteve.
- Edukimi i punonjësve dhe punëdhënësve potencialë me legjislacionin e punës dhe kontratat e punës, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet.

“Përfshirja e palëve të interesuara është thelbësore për përgatitjen e një strategjie kombëtare punësimi që lidh në mënyrë efektive kërkesat e biznesit me atë që ofron tregu. Kjo përfshin angazhimin e bizneseve, akademisë dhe donatorëve të rëndësishëm, duke përfshirë ekspertizën e tyre dhe pilotimin e projekteve. Unë besoj fuqimisht se zhvillimi i një strategjie të tillë do të marrë kohë dhe shpresoj se dhomat e tregtisë do të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.”

Ines Muçostepa, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, 26 tetor 2022

KONSULTIME



Diskutim teknik “Për përmirësimin e procesit të konsultimit publik”

20 prill 2022

Sekretariati zhvilloi një diskutim teknik me palët e interesuara, private dhe publike për konfirmimin e gjetjeve dhe sugjerimeve paraprake për përmirësimin e procesit të konsultimit publik. Pjesëmarrësit konfirmuan se gjetjet evidentonin problematikat kryesore të konsultimit publik nga perspektiva e biznesit dhe ndanë përvojat e anëtarëve të tyre. Ata theksuan sfidat e pjesëmarrjes së biznesit në proces, veçanërisht mungesën e angazhimit dhe reagimit në kohë nga institucionet e administratës publike. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për të rritur besimin e palëve në proces, kërkuan mbështetje për rritjen e kapaciteteve të shoqatave të biznesit si edhe kërkuan që të ndërmerren më shumë veprime ndërgjegjësimi për përmirësimin e situatës.

Diskutim teknik “Sfidat e brezit të ri për të hyrë në tregun e punës”

29 shtator 2022

Organizuar në bashkëpunim me Young Professional Network (YPN), pjesëmarrësit shprehën nevojën për një ndryshim të mentalitetit ndaj punës, i cili duhet të fillojë nga familja dhe të përforcohet nga shoqëria në tërësi. Ata theksuan rëndësinë e aftësive praktike dhe sugjeruan që shkollat duhet të përshtaten me nevojat aktuale të tregut të punës për të përgatitur më mirë brezin e ri.

Takimet teknike rajonale “Sfidat e NVM-ve gjatë tranzicionit në burime alternative të energjisë”

Dhjetor 2022

Sekretariati zhvilloi takime rajonale fokus grup mbi sfidat me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në kalimin drejt burimeve alternative të energjisë. Takimet kishin për qëllim promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit efikas me NVM-të dhe palët e tjera të interesuara për të identifikuar sfidat dhe rekomandimet kryesore për adresimin e tyre. Gjithsej 37 kompani morën pjesë në takimet e fokus grupeve, duke përfaqësuar industri dhe sektorë të ndryshëm nga Durrësi, Korça, Vlora dhe Tirana. Takimet dhanë njohuri të vlefshme për sfidat me të cilat përballen NVM-të në kalimin drejt burimeve alternative të energjisë, duke përfshirë çështje që lidhen me financimin, kapacitetin teknik dhe kuadrin rregullator.

REKOMANDIME TË PËRMBUSHURA GJATË VITIT 2022



KI ka analizuar dhe miratuar 295 rekomandime për përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri (2015-2022) në sajë të përfshirjes së anëtarëve e tij në një dialog efektiv publik-privat. Nga këto rekomandime, **44% tashmë janë zbatuar në nivelin 70-100%, 16% janë në proces zbatimi dhe 40% mbetur ende për zbatim.** Sekretariati ka mbajtur një qasje transparente duke publikuar vazhdimisht përditësime mbi progresin dhe duke rritur ndërgjegjësimin për të siguruar llogaridhënie nga ana e qeverisë dhe palëve të tjera të interesuara. Veçanërisht, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka treguar një përkushtim më të madh për zbatimin e rekomandimeve të KI-së duke raportuar ecurinë për 14 rekomandime.

Zbatimi i rekomandimeve të KI gjatë vitit 2022 ndikoi në disa fusha kyçe, si më poshtë:

- » **Konsultimi publik dhe vendimmarrja:** Rekomandimet e propozuara synonin përmirësimin e konsultimit publik si një mjet efektiv për vendimmarrje dhe dialog ndërmjet bizneseve dhe institucioneve publike.
- » **Fuqia punëtore:** Masa konkrete mbi problematikën emergjente të mungesës së fuqisë punëtore dhe kualifikimit të saj.
- » **Bujqësia dhe Zhvillimi Rural:** Në vijim edhe të rekomandimeve të KI, MBZHR inicioi përmirësimet ligjore dhe përafrime me kërkesat e BE-së për ligjin "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre", i cili synon dhënien e përparësisë për produktet vendase, dhe Ligjin "Për vreshtat dhe verërat" që synon të rrisë cilësinë e prodhimit të mbi 60 kantinave. Rekomandime të tjera u fokusuan në përpunimin e një inventarizimi të pronave publike bujqësore dhe forcimin e cilësisë dhe përputhjes me standardet e produkteve vendore.
- » **Taksa:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) zbatoi rekomandimet për dixhitalizimin e procedurave të rimbursimit të TVSH-së, krijimin e një njësie të posaçme kundër informalitetit për të ardhurat nga punësimi dhe shërbimet dhe krijimin e një baze të dhënash me subjektet që operojnë në sektorin e turizmit për të lehtësuar punën e struktura në varësi të DPT.
- » **Tregtia Elektronike dhe Investimet:** Rekomandimet për hartimin dhe ndarjen e Planit të Veprimit për tregtinë elektronike, aktivizimin e sekretariateve teknike të Grupit të Menaxhimit të Politikave të Integruara të GMIP në fushën e konkurrueshmërisë dhe investimeve, si dhe hartimin e Programit të Eksportit, kanë qenë në zbatim e sipër.
- » **Reforma e Inspektimeve:** Inspektorati Qendror informoi mbi progresin në lidhje me kalimin në fazën e konsultimit online në tetor 2022 të projektligjit "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", duke e bërë Inspektoratin Qendror pjesëmarrës në procedurën e inspektimit të zhvilluar nga inspektorati shtetëror dhe vendor dhe popullimin e sistemit elektronik "e-Inspektimi".
- » **Dixhitalizimi i Procedurave të Lejeve të Ndërtimit:** Agjencia e Zhvillimit të Territorit raportoi progres në lidhje me rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm të funksionalitetit të platformës e-Lejet dhe trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore që merren drejtpërdrejt me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit përmes platformës e-Lejet.
- » **Sipërmarrja dhe Inovacioni:** Progres në lidhje me rekomandimet për nxitjen e inovacionit në sipërmarrje nëpërmjet miratimit të të gjitha akteve nënligjore që i referohen ligjit "Për mbrojtjen dhe zhvillimin e startupeve inovative", i cili mundësoi mbështetjen e komuniteti startup me një fond të dedikuar prej 10 Mil Euro të akorduar nga Qeveria Shqiptare.

Forcimi i zbatimit të reformave

Zbatimi i rekomandimeve të KI është lehtësuar dhe forcuar në sajë të mbështetjes me projekte vijuese nën drejtimin e BERZH-it dhe mbështetjes së Sekretariatit Shtetëror Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO)

Kl ka forcuar zbatimin e rekomandimeve të tij përmes mbështetjes së ofruar nga BERZH me projekte vijuese. Një projekt i tillë i llojit asistencë teknike u ofrua me qëllim krijimin e një Portali Online të Fermerëve dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit Rural (AZHBR). Projekti thjeshtoi procedurat, reduktoi barrën administrative dhe përmirësoi informacionin dhe konsultimin për fermerët dhe agrobizneset. Projekti krijoi gjithashtu një platformë

online për fermerët, duke ofruar informacion të centralizuar për akses më të mirë në shërbimet financiare dhe çmimet e tregut të produkteve bujqësore. Arritjet kryesore përfshijnë përmirësimin e aksesit në financim dhe shërbime të ngjashme dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mundësitë e financimit. Në përgjithësi, projekti synonte të përmirësonte shërbimet dhe kapacitetin institucional të AZHBR-së dhe të lehtësonte aksesin më të lehtë dhe më efikas në financim dhe shërbime të ngjashme për fermerët dhe

Dokumente



Klikoni mbi titullin e dokumentit për ta shkarkuar.

JANAR 2022

Mbledhje XXVI – Axhenda
Mbledhje XXVI – Prezantimi PPT
Mbledhje XXVI – Minutat

QERSHOR 2022

Mbledhje XXVII – Axhenda
Mbledhje XXVII – Prezantimi PPT
Mbledhje XXVII – Dokument Pune “Për Përmirësimin e Konsultimit Publik”
Mbledhje XXVII – Matrica e Rekomandimeve
Mbledhje XXVII – Minutat

TETOR 2022

Mbledhje XXVIII – Axhenda
Mbledhje XXVIII – Prezantimi PPT
Mbledhje XXVIII – Dokument Pune “Mbi disponibilitetin dhe aftësitë e fuqisë punëtore”
Mbledhje XXVIII – Matrica e Rekomandimeve
Mbledhje XXVII – Minutat

PUBLIKIME

“Covid-19 dhe Ndërmarrjet në Shqipëri”, Analizë Krahasuese 2020-2021
Gjetjet e Anketës “Mbi Disponueshmërinë dhe Cilësinë e Fuqisë Punëtore”
Gjetjet e Anketës “Mbi Sfidat e të Rinjve në Tregun e Punës”
Vështrim mbi Treguesit Makro-Ekonomik, Janar-Dhjetor 2021
Vështrim mbi Treguesit Makro-Ekonomik, Janar-Qershor 2022
Reportim mbi Progresin e Rekomandimeve të KI (Gusht 2022)
Raportim mbi Progresin e Rekomandimeve të KI (Dhjetor 2022)
Komente nga Anëtarë e Bashkëpunëtorë të KI, 2022
Raport mbi Aktivitetin e KI, 2021
Raport Monitorimi i Rekomandimeve të KI, 2022

Komunikim dhe Vizibilitet



FAQJA E INTERNETIT:

» 3,710 përdorues në 2022

MEDIAT SOCIALE:

» Aktiv në 3 platforma: Facebook, Twitter, LinkedIn
» Rritje prej 22% në numrin e ndjekësve: (3,360 në 2022 krahasuar me 2,763 në 2021)

BULETINË TREMUJORË

Shpërndarë në mënyrë elektronike tek të gjithë partnerët e KI-së dhe postuar në mediat sociale.

» Buletini, janar-mars 2022
» Buletini, prill-qershor 2022
» Buletini, korrik-shtator 2022
» Buletini, tetor-dhjetor 2022

ARTIKUJ NË MEDIAN E SHKRUAR

» Këshilli i Investimeve, Ministria e Financës: Problem punësimi i grup-moshës 15-29 vjeç! 10.5% e forcës aktive për punë, s’beson në punësim – Shqiptarja.com, 26 tetor 2022
» Përse nuk punojnë të rinjtë? Arsyeja kryesore janë pagat e ulëta, sipas sondazhit – Revista Monitor, 15 nëntor 2022
» Anketa e Këshillit të Investimeve, 55% e kompanive nuk kanë buxhete për trajnimin e punonjësve – Revista Monitor, 22 nëntor 2022

PREZENCË MEDIATIKE NË KANALET KOMBËTARE TELEVIZIVE RTSH

» Mblidhet Këshilli i Investimeve, plan veprimi për përmirësimin e klimës së biznesit – RTSH, 31 janar 2022

Ora News TV

» Nënshkruhet memorandum mes Këshillit të Investimeve dhe Fakultetit të Ekonomisë – Ora News, 11 qershor 2022
» Papunësia te të rinjtë, Ibrahimaj: Institucionet të afishojnë vendet e lira të punës – Ora News, 26 tetor 2022

Zyra e Shtypit e Kryeministrisë

» Kryeministri Edi Rama me shoqatat e biznesit mbi rekomandimet e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit – Zyra e shtypit e Kryeministrisë, 9 shtator 2022

MARKETING ME E-MAIL

(SHPËRNDARJA E NJOFTIMEVE PËR SHTYP)

» 1,000 të abonuar
» Shpërndarë në anglisht dhe shqip
» 22% mesatarja e leximit të njoftimeve

Angazhimi i partnerëve

Gjatë vitit 2022, Sekretariati bashkëpunoi me aktorë të ndryshëm për të promovuar punën e KI-së përmes tryezave të rrumbullakëta teknike dhe diskutimeve me dhomat e tregtisë dhe organizatat rajonale të biznesit në Vlorë, Durrës, Korçë dhe institucione të tjera si Ministria e Infrastrukturasë dhe Energjisë, Agjencia e Eficiencës së Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Instituti i të Drejtave të Pronësisë, Parlamenti dhe Zyra e Kryeministrit. Përveç mbledhjeve plenare, këto partneritete ndihmuan në rritjen e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara për ndikimin e KI-së dhe kontribuan në iniciativa dhe forume të tjera komunikimi. Gjithashtu, Sekretariati rriti numrin e botimeve të tij për të zgjeruar rrjetet dhe për të rritur kontributin në nismat përkatëse.

SHIFRA TË RËNDËSISHME GJATË 2022

- » **173** pjesëmarrës nga biznesi në mbledhje të KI dhe takime teknike
- » **3 mbledhje të KI me nivel pjesëmarrje prej 80%**
 - **5 tryeza teknike** (fokus grup)
- » **80 konsultime individuale** me aktorë të ndryshëm për verifikimin e gjetjeve dhe rekomandimeve përpara mbledhjeve plenare
- » 4 anketa:
 - Pyetësor mbi konsultimin publik (26 shoqata biznesi)
 - Pyetësor/anketë "Për disponueshmërinë dhe cilësinë e fuqisë punëtore" (253 kompani)
 - Pyetësor/anketë "Për sfidat e fuqisë së re punëtore" (262 të rinj)
 - Pyetësor "Komente nga Anëtarë të KI dhe Partnerë 2022" (21 persona)

- » **Pjesëmarrja gjinore në aktivitetet e KI:** 40% burra, 60% gra
- » Shoqatat dhe dhomat e biznesit, anëtarë të KI, përfaqësuan interesat e 1319 kompanive, sipas një përditësimi të Sekretariatit bazuar mbi informacionin publik të nivelit të anëtarësimit të anëtarëve aktual të biznesit.



TË TJERA

Avokim dhe ndërgjegjësim

Për rritje të rolit të shoqatave të biznesit në promovimin e qeverisjes së mirë dhe luftës kundër korrupsionit – Kontributi si panelist në Konferencën e parë të Nivelit të Lartë Kundër Korrupsionit të udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit

Drejtorja e Sekretariatit mori pjesë si paneliste në një sesion të fokusuar mbi rolin e shoqatave të biznesit në promovimin e qeverisjes së mirë dhe luftën kundër korrupsionit gjatë Konferencës së parë Anti-Korrupsion të drejtuar nga Zyra e Kryeministrit. Sekretariati ndau analizën e tij se bizneset e njohin dixhitalizimin si një mjet kyç në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, bizneset kanë vënë në dukje gjithashtu se problemet kryesore sistematike që çojnë në informalitet janë ndërveprimi me institucionet publike dhe paqëndrueshmëria fiskale.

Për lehtësimin e aksesit të sektorit privat në shërbimet inovative financiare – Kontribut në forumin “Dixhitalizimi kundrejt parasë fizike” në bashkëpunim me Shoqatat e Bankave

Forumi kishte për qëllim lehtësimin e aksesit të sektorit privat në shërbimet inovative financiare. Drejtorja e Sekretariatit theksoi rolin kyç që luajnë bankat në reduktimin e parasë fizike në ekonomi dhe ofrimin e kanaleve alternative të pagesave. Ajo rekomandoi gjithashtu nevojën për një analizë të qëndrueshme të progresit të arritur deri më sot dhe sfidave aktuale me të cilat përballen të gjitha palët e përfshira përpara se të zbatohen ndërhyrje të reja financiare dixhitale.

Për përmirësimin e klimës së biznesit – Kontribut në dialogun midis Kryeministrit dhe shoqatave të biznesit dhe dhomës së tregtisë
Kryeministri i Shqipërisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë zhvilluan një takim me shoqatat e biznesit, dhomat e tregtisë dhe anëtarët e KI për të diskutuar ecurinë e procesit të konsultimit lidhur me rekomandimet e bizne-

sit për përmirësimin e klimës së biznesit. Ky proces filloi në tremujorin e fundit të vitit 2021 dhe u lançua zyrtarisht gjatë mbledhjes së KI më 31 janar 2022. Lista e rekomandimeve përfshinte 26 çështje të ngritura nga KI, të fokusuar në reduktimin e informalitetit, përmirësimin e shërbimeve publike, përsheptimin e dixhitalizimit, lehtësimin e tregtisë elektronike, thjeshtimin e proceseve të inspektimit dhe përmirësimin e aftësive të kapitalit njerëzor.

Avokimi për politikën e IHD-ve për të rritur konkurrencën e NVM-ve të drejtuara nga gratë – Kontribut në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Dhoma Ekonomike e Gruas

Fokusi i diskutimit ishte klima e investimeve dhe ekonomia e gjelbër. Gjatë tryezës së rrumbullakët, Drejtorja e Sekretariatit theksoi rëndësinë e politikave të IHD-ve që promovojnë inovacionin vendas, menaxhimin dhe promovimin e eksportit në nivel firme. Sekretariati theksoi se këto politika janë thelbësore për ruajtjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve lokale në pronësi të grave dhe stimulimin e krijimit të vlerës së shtuar nga NVM-të, duke përfshirë ato në industritë nxjerrëse. Sekretariati inkurajoi gjithashtu gratë sipërmarrëse që të marrin një rol më proaktiv në avokim përmes shoqatave të grave, pasi ato mund të shprehin dhe mbrojnë më mirë çështjet e tyre të biznesit së bashku.

Sipërmarrësit kanë nevojë për më shumë dixhitalizim dhe të dhëna për të përballuar më mirë rreziqet e biznesit

Në aktivitetin lançues “Gratë sipërmarrëse dhe perspektiva gjinore në zinxhirin e vlerave të biznesit” organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Drejtuesja e Sekretariatit theksoi se pandemia kapi në befasi të gjitha strukturat funksionale social-ekonomike të shoqërisë, përfshirë botën e biznesit. Kriza e Covid-19 shtyu shtetin dhe biznesin të ridimensionojnë

rolet dhe nivelin e bashkëpunimit, duke afuar sipërmarrjen me shkencën dhe duke rritur nevojën për vendimmarrje të bazuara në të dhëna. Ndërsa theksoi rëndësinë që gratë dhe të rinjtë që dëshirojnë të investojnë në Shqipëri duhet të marrin informacion të përditësuar për të bërë biznes, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shoqatat e biznesit dhe dhomat.

Kontributi në draftin e Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023-2030

Gjatë një takimi konsultativ të organizuar nga MFE, Drejtorja e Sekretariatit theksoi rëndësinë e investimit në kapitalin njerëzor dhe qeverisjen korporative për konkurrueshmërinë e bizneseve dhe inkurajoi shoqatat dhe kompanitë të investojnë më shumë në këtë drejtim. Gjithashtu, ajo bëri thirrje për kapacitete më të mira koordinuese institucionale në platformat e konsultimit, veçanërisht në aspektin e procedurave dhe masave, pasi ky është një prioritet në funksion të procesit të BE-së.

Rritje të ndërgjegjësimit ndaj projekteve të donatorëve

Sekretariati ka qenë aktiv në ndërgjegjësimin e komunitetit të donatorëve mbi rëndësinë e koordinimit të projekteve të tyre me rekomandimet e KI-së për përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri. Si anëtar i komitetit drejtues në projektet zvicerane si ‘RisiAlbania’ dhe ‘Skills for Job’, Sekretariati ka kontribuar aktivisht në përcaktimin e drejtimeve strategjike që përputhen me rekomandimet e KI-së. Gjithashtu, Sekretariati ka dhënë komente mbi raportin e progresit të BE-së për vitin 2022 duke theksuar fushat ku është bërë përparim dhe ku nevojiten përmirësime të mëtejshme.

Partneritet me akademinë për forcimin e klimës së biznesit

KI dhe Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin

e Tiranës (FEUT) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për përmirësimin e klimës së biznesit në vend. Memorandumi parashtroi një kuadër bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, e cila përfshin shkëmbimin e informacionit, ekspertizën teknike dhe profesionale, njohuritë dhe përvojën, promovimin e aktiviteteve dhe forumeve të ndërsjella dhe krijimin e një kuadri monitorimi për të ndjekur dhe zbatuar rekomandimet e KI-së. Memorandumi thekson rëndësinë e bashkëpunimit të përbashkët midis akademisë dhe KI-së për përmirësimin e mjedisit të biznesit në Shqipëri.

Fuqizimi i të rinjve në tregun e punës

Partneriteti me shoqatat rinore është thelbësor për krijimin e zgjidhjeve efektive që plotësojnë nevojat e punëkërkesve të rinj. Duke punuar me organizatat të tilla si Rrjeti i Profesionistëve të Rinj (YPN), KI fitoi njohuri të vlefshme për sfidat specifike të tregut të punës me të cilat përballen të rinjtë. Partneriteti me shoqatat rinore mund të ndihmojë në ndërtimin e ndjenjës së përkatësisë dhe fuqizimit tek të rinjtë, duke i frymëzuar ata që të formojnë të ardhmen e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të komuniteteve të tyre.

Dialog me përfaqësues të lartë të BERZH-it mbi probleme të klimës së investimeve


Sekretariati organizoi një tryezë të rrumbullakët me anëtarë të biznesit të KI-së dhe përfaqësues të lartë të BERZH-it për të diskutuar sfidat me të cilat përballen sektori privat shqiptar, si konkurrueshmëria, fuqia punëtore, digjitalizimi, informaliteti, etj. Tryeza e rrumbullakët i dha mundësinë anëtarëve për të shkëmbyer mendime me përfaqësues të lartë të BERZH-it mbi sfidat kryesore me të cilat përballen sektori privat shqiptar. Qëllimi ishte identifikimi i fushave të bashkëpunimit për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin e bizneseve në Shqipëri.

Anketat e KI mbi aftësitë dhe disponueshmërinë e fuqisë punëtore, dhe sfidat e fuqisë së re punëtore (2022)

Sondazhet janë instrumente të vlefshme për angazhimin dhe gjithëpërfshirjen e biznesit (sipas metodologjisë poshtë-lart), tashmë pjesë e punës së KI-së që prej vitit 2015. Anketat e KI-së për vitin 2021 u përgatitën nga Sekretariati në formën e një pyetësoi të strukturuar. Sondazhi i parë mbledhi në mënyrë rastësore përgjigje nga 253 kompani me qëllim përfitimin e njohurive mbi qasjen e bizneseve për adresimin e mungesës së fuqisë punëtore. Sondazhi i dytë mbledhi përgjigje nga


262 të rinj nga e gjithë Shqipëria dhe kishte si qëllim krahasimin e gjetjeve me ato të anketimit të biznesit dhe për të vlerësuar perceptimin e tyre për këtë sfidë mbizotëruese në vend. Sondazhi zbuloi se kompanitë përballen me një kontekst sfidues rekrutimi, me tre të katërtat që raportojnë se kanë vështirësi në plotësimin e vendeve të lira të punës. Për të adresuar mungesën e aftësive të fuqisë punëtore, bizneset tashmë janë duke u fokusuar kryesisht në rritjen e trajnimeve brenda kompanive dhe/ose riorganizimin strukturor të tyre.

Aktualisht a hasni vështirësi në sigurimin e fuqisë punëtore?




Anketa e Sekretariatit me Bizneset "Mbi Disponueshmërinë dhe Cilësinë e Fuqisë Punëtore" (tetor 2022)

Çfarë veprimesh ndërmerr kompania për të zgjidhur mungesën e aftësive të punonjësve ekzistues?



Bazuar në eksperiencën tuaj, çfarë konsideroni si 3 pikat më motivuese në punësim?




Anketa e Sekretariatit me të Rinjtë "Mbi Sfidat e Fuqisë Punëtore" (tetor 2022)

Planet për të ardhmen

KI do vazhdojë të luajë një rol kryesor në lehtësimin e dialogut midis qeverisë dhe sektorit privat, duke kontribuar në rikthimin e besimit në vend për investitorët, forcimin e mjedisit të biznesit dhe adresimin e sfidave afat-mesme dhe afat-gjata me të cilat përballen bizneset. Axhenda e KI për 2023 u votua nga anëtarët dhe temat kryesore për vitin e ardhshëm janë "Sfidat e SME-ve gjatë kalimit në burime alternative të energjisë", "Dijitalizimi i Shërbimeve dhe Cilësia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Dixhitalizuara për Bizneset" dhe "Eficienca e Energjisë në kuadrin e Stimulimit të Tranzicionit Energjetik dhe Programeve Mbështetëse". Ndërkohë, KI do të mbledhet katër herë gjithë vitit për të diskutuar ecurinë e axhendës dhe për të shkëmbyer mendime mbi klimën e biznesit në Shqipëri. Sekretariati do të vazhdojë të organizojë takime konsultimi dhe të avokojë zërin e sektorit privat në tryeza dhe grupe pune. Vrojtimet me bizneset do të vazhdojnë të jenë pjesë e punës së Sekretariatit, ndërsa do të vazhdohet monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga KI dhe rritjes së ndërgjegjësimit për aktivitetet

Numra të Rëndësishëm 2022



Anëtarë të KI gjatë 2022

Anëtarë, Institucione Shtetërore	<ul style="list-style-type: none"> Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Banka e Shqipërisë Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
Anëtarë, Partnerë për Zhvillim	<ul style="list-style-type: none"> Banka Botërore Delegacioni i BE-së në Shqipëri Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)
Anëtarë të Biznesit me Mandat të Përhershëm	<ul style="list-style-type: none"> Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë Tiranë Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL) Dhoma Shqiptare e Diasporës
Anëtarë të Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	<ul style="list-style-type: none"> Dhoma Ekonomike e Gruas (WECA) Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham) Dhoma Turke e Tregtisë dhe Industrisë (ATTSO) Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë
Anëtarë të Tjerët të Biznesit	<ul style="list-style-type: none"> Vodafone Albania Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA) Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA) Antea Cement Proeksport Albania (PEA)

ACTIVITY REPORT 2022



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Staf

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoreshë e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha


Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

Albania Investment Council ALInvestCouncil Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).